# ANSAMBLI FOLKLORIK AUTOKTON

# “ RUGOVA”

# PORTOFOL

## AKTIVITETET E AFA “RUGOVA” 2021

AFA Rugova gjatë vitit 2021 ka zhvilluar këto aktivitete dhe ate ;

1. Festvale 3
2. Talme kulturore 5
3. Manfestime 9
4. Projekte 3
5. Inqizime 2

## ArtEko

ArtEko organizoi edicionin e tretë të festivalit kulturorë "Camping Fest" 2021
Në ditën e parë të aktiviteteve u mbajt mbrëmja qëndrore në lokalitetin arkeologjik të Dresnikut.
Mbrëmja u hap nën interpretimin e balerinave "zanave" të vogla, që gjallëruan agjenden e ngjeshur, pastaj moderatorja e eventit Jehona Gashi i dha hapësirë intepretimit me kitarë nga Gentrit Mrasoraj.
Musafirëve ju uroi mirësardhje Vlora Gashi - drejtoreshe e ArtEko-s, për të vazhduar me fjalë rasti nga drejtori i Institutit Arkeologjit të Kosovës - Enver Rexhaj.
Fjalë përshëndetëse pati edhe nga nënkryetari i komunës së Klinës - Besim Hoti, si dhe nga drejtori i komunal i bujqësisë - Naser Morina, të cilit iu nda mirënjohje nga organizata, për kontributin e dhënë në edicionit e parë të këtij festivali.
- Pasoi programi me elemente tradiconale:

- "Oda e Lalës" nga Ismet Krasniqi - Lala, i cili pati musafir Ansamblin Autokton të Këngëve dhe Valleve "Rugova", të cilët begatuan eventin me këngë malsorçe, tinguj lahute, dhe valle rugovase. Pastaj mbrëmja vazhdoi me darkën tradicionale.




Për argëtimin e musafirëve u kujdes Jehona Lumi dhe bendi i saj, e po ashtu për adrenalilën u kujdesën edhe Dj Gosti dhe Dj Poni. Mbrëmja u përmbyll nën tigujt e kitarës rreth zjarrit me poezi nga kriuesit e Klinës.

ArtEko falënderon për mbështetjen komunën e Klinës, përkatësisht DKRS-në, sponsorët dhe gjithë ata që kontribuan në realizimin e këtij eventi.



# FESTIVALI LAHUTES DHE OKARINES 2021








# Festivali “Sofra Dardane” mbledh 1 mijë artistë nga trevat shqiptare në Bajram Curri

Nga
**Ilir Vata**
-
12/06/2021



**Festa e Flamurit   28 Nëntori**



**Viti i Demë Ali Pozharit**

dhe tibuneve  Sali Rama, Mehmet Gradica , Bike Dreshaj











Komuna e Deqanit meOrganizatën "Martin Dreshaj" organizojnë akdemi përkujtimore "Viti i Demë Ali Pozharit dhe Tribunëve të Kombit Sali Rama, Mehmet Gradica dhe Bilall Bik Dreshaj". Tubimi u mbajtt në Sallën e Asamblesë Komunale në Deçan! Më datë 18.12.2021, ora 11:00h!

Referues: Faton Mehmetaj, Valdet Hysenaj , Shoqata e Historianeve, djali Deme Ali Pozharit

# QENDRA KOMBËTARE E VEPRIMTARIVE FOLKLORIKE

Adresa: Rr: "Gezim Erebara" prane pallatit nr. 31, Tiranë

Tel: 04 225 4580

Të nderuar miq,

Qendra Kombëtare e Veprimtarive Tradicionale (QKVT), organizon në Gjirokastër një veprimtari me rastin e 29 Shtatorit, Ditës Kombëtare të Trashëgimisë Kulturore. Kjo veprimtari që organizohet në bashkëpunim me strukturat kulturore e artistike vendase, ka në përmbajtje Panairin e Artizanatit dhe Mjeshtërisë së Punimit të Instrumenteve Popullore si dhe një Koncert Artistik me grupe nga Qarku Gjirokastër.

Veprimtaria hapet dt. 29.09.2021, ora 16.00 në pjesën muzeale pranë Pazarit të qytetit me Panairin dhe më pas, në ora 18.00 do të vijojë me Koncertin Folklorik.

Me këtë rast kemi nderin të ftojmë edhe një grup artistik nga Ansambli "Rugova", Pejë. Lutemi që grupi nga Kosova të ketë në program këngë e valle të trevës suaj mundësisht edhe me përfshirjen e artistëve të rinj si mesazh i transmetimit të Trashëgimisë Kulturore Kombëtare ndër breza. Numri limit i artistëve kosovarë mundësisht të jetë deri në 14 persona. Organizatorët marrin përsipër akomodimin e grupit tuaj (fjetje + ushqim) ndërsa transporti do të mbulohet nga ana juaj.

Faleminderit për mirëkuptimin!







# Zbulimi Bustit Anton Çettës - Klinë 01.05.2021





# Osman Ferizi është me Ismet Azizi dhe 12 të tjerë

•

c4 dSchjet5or në 9is:556or7 12eM23Ddu ·

Shteti Yne- a ke vesh a ke sy. Per 20-vite mohim dhe injorim!
Ngjarje madheshtore ne kryeqytetin e Dukagjinit- Peje, aty ishte e gjithe Shqiperia( Tirana, Shupi, Tetova, Drenica,Kumanova, Llapi, Gostivari, Mitrivica…!
Sot ne Peje u shenua nji ngjarje historike- 02.12.2021, nji date qe shenoi nji kthese dhe ndryshim politiko- ushtarak ne harten etnike Shqiptare. Hyrja e grupit te dyte te armatosur prej 32-vetash te prire nga komandanti dhe drejtuesi i PARË - SALI ÇEKAJ, nji organizim institucional i krijuar, ideuar dhe mbeshtet nga Presidenti historik dr. I. Rugova, nga keto dy grupe guerile i kemi themelet dhe drejtuesit autentik te USHTRISE se Kosoves(UCK-se) - S. Cekaj, A. Jashari. Z. Pajaziti dhe A. Hoxha. Falenderim per kryetarin e komunes se Pejes dhe stafit te tij z. Gazmend Muhaxheri. Vendosja e Pllakes Memoriale ne fsh. e lindjes se heroit SALI ÇEKAJ ne Broliq ku mori pjese edhe e veja e heroit Ilaz Kodra- zonja Kimete Kodra.Mohuesit, falsifikatoret, perfiteret e historise do jene humbesit me te medhenje.
Lavdi dhe nderim heronjeve!
Zoti e bekoft Shqiperin dhe Shqiptaret kudo!
Peje. 02.12.2021.13.00!



10.06.2021http




Sot janë bërë 143 vite prej një dite të veçantë kur u mblodh Kuvendi i cili themeloi lidhjen e parë mbarë-shqiptare, një prej ngjarjeve më të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar.

Për nder të kësaj dite në qytetin e Prizrenit u mbajtën aktivitete të shumta, një organizim ky nën patronatin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në bashkëpunim mes Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Prizrenit.

Në këtë ngjarje të pranishëm ishin Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës z.Glauk Konjufca, Ministri i MKRS, z. Hajrulla Çeku, Kryetari i Komunës së Prizrenit z.Mytaher Haskuka, deputetë dhe shumë pjesëmarrës të tjerë.

Aktivitetet filluan me Homazhe tek shtatorja e prijësve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, për të vazhduar më tutje me fjalimet.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës z. Glauk Konjufca ndër të tjera tha që Lidhja e Prizrenit paraqet kulmin politik të Rilindjes Kombëtare, ndërsa Ministri z. Çeku foli për rëndësinë që ka kjo datë për historinë tonë, ndërsa theksoi përkushtimin e MKRS për përmirësimin e kushteve në Kompleksin Monumental të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në mënyrë që mesazhi shumë i rëndësishëm historik të prezantohet, promovohet dhe të bartet në gjeneratat e ardhshme, duke tejkaluar edhe kufijtë kombëtarë.

Organizimi vazhdoj me një recital nga z. Armend Baloku, aktor dhe me vizitë në ndërtesën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ku u bë prezantimi i veshjeve të Rugovës, Hasit, Lumës, Dibrës, Gurit të Bardhë, Matit, Hotit dhe Grudës.

Në këtë ngjarje Ministri z. Çeku, ishte i shoqëruar nga zëvendësministri z.Sejnur Veshall dhe Këshilltarja politike znj. Nora Arapi Krasniqi.

**0**



# Kalaja Drishtit - Postribe 22 Maj 2021











Ishte kenaqesi e veqant qe AFA Rugova te gershtohej Trashegimin shpirterore te  etnoregjionit Rugoves me trashegimin materiale te Kalas

Grishtit  . Atrakcion boteror i lashtesise  qenjes tone .

# Sakrifica Kombetare per Liri e pavaresi

1ctS4 qhpmetrrirresahoorensr endëe 5:doc36 riorMaessDdnng ·

Foto nga organizimi tematik e kulturor me rastin e 22 vjetorit te çlirimit te Kosoves,143 vjetorit te Lidhjes Shqiptare te Prizrenit,110 vjetorit te kryengritjes se Malesise se Madhe,demostratave te viteve 68 e 81,levizjes se pajtimit te gjaqeve,levizjes paqesore dhe luftes se UÇK se,u mbajt ky aktivitet ku kumtesat e tyre i shpalosen referues nga trojet etnike:Shkodra,Tuzi,Medvegja,Klina,Istogu,Peja .Ky organizim u mbajt nga Shoqata e vellazerise Kosove-Malesi e Madhe"Martin Dreshaj"ne Peje.Falenderojme per kontribut te gjithe pjesemarresit,veqanerisht ata nga trojet shqiptare si:Shoqaten Atdhetare "Dukagjini" me ne krye Ndue Sanaj Shkoder,pjesemarresit nga Tuzi-Gjergj Camaj,Mark Junçaj,Marash Dedvukaj e Kole Vulaj,historianet nga Kosova-Jusuf Mavraj me ekip,nga Klina-Ismet Krasniqi me grup,nga Medvegja-Rexhep Abazi me grup,poetet Lulash Brigja,Agim Desku,Rame Thaqi,Idriz Berisha,Kole Vulaj,Ansamblin Autokton Rugova me Vesel Nikçin ne krye,Florim Nikqin e Fatos Selmaj,Petrit Karaqica,Kreshnik Blaka,Rtv Fontana,Zek Sinanaj nga Rt i Kosoves,redaksine e Tv te Malit te Zi ne gjuhen Shqipe me Marash Dedvukaj gazetar,pronarin e Restorant Rugova Camp,sindikaten e arsimit te









## Shenim Florim Nikqi dhe Shaban Demaj

•

13.10.2021 Muzeu i Pejes ·

Sot na nderuan me paraqitjen e lashtësisë shqiptare ansambli autokton Rugova para njohesit etnomuzikolog nga gjermania Rolf Killius, lashtësia shqiptare nga antikiteti deri sot është e gjallë ne ansamblin autokton Rugova, i falënderojme përzëmërsisht më paraqitjen briliante në Muzeun e Pejës,



## Rolf Killius ndau një video nga lista e luajtjes Competition | Meet the Maker.

3l0S1 te0pt4ohifr1 gnorë ui11:40 dP0D ·

**https://www.facebook.com/watch/live/?ref=watch_permalink&v=400163751569316**

**Nifffi ishte drejtpërdrejt.**

# Takimi Kulturor  i AFA Rugova

## Mysafiret nga Zvicrra

## Dt .08.0702021

Ne pritje e perzemert e Mysafireve nga Berni Zvicerr te prir nga z Kristian me gjithe komunitetin Besimtar ne krye me Kishen Protestane  Bern.

Shoqeruar nga Humanistja Behide Hasanaj.

Ishte kenaqesi qe ti presim miqt e te gjitha komuniteteve fetare nga Zvicrra , se bashku me Dekan Dom Lorencin  Sopi , z Dom Zranja nga kisha jone Katpike Shen Katarina, dhe z. Mulla Sadria  prijs I Gjeatit Podgurit .

Ligjerimi ne gjermanisht  I zotit Dom Franja   per Tolrancen shqipetare  nderfetare zgjoi kurreshtje te madhe te  prijsit e komunitetit fetar Zvicerran. AFA Rugova kishte kenaqesin qe te paraqes nje program para tyre  duke iu kethyer viziten dy here rradhazi kur ansambli ishte atje ne Bern.

Vesel Nikçi paraqiti kumtesen per  Rugoven Atrakcion boteror turistik dhe  etnoregjion specifik shqiptar.



# DITA E PLISIT,

Në Kosovë për 8 vite me rradhë mbahet një manifestim tradicional kulturor që e kan pagëzuar Këtë vit u mbajt në Stankaj të Rugovës, në kullën e Hysen Kurtajt (lahutar i njohur.) Manifestimin e drejtoi, ideatori Ismet Krasniqi Ndërmjet kumtesave nga të pranishmit pati edhe pika muzikore nga rapsodet : Rifat Berisha me grupin e tij, Gjon Krasniqi (diasporë, SHBA), Nazmi Hajdari. Me lahutë: Hysen Kurtaj Gjelosh Fusha , Ansambli “Rugova”. etj.
Grupi i Shoqata Atdhetare “Dukagjini” i përbërë nga Ndue Sanaj, Anton Kosteri Gjelosh Fusha Zef Kosteri dhe Lulash Brigja, veç të tjera në emër të Shoqatës ndau disa mirënjohje .
Z. Frrok Kristajn, Bajram Kelmendi(post mortum), dr. prof. Zymer Neziri. Tahir Bezhani Sejdi Berishë , Gjon Gjergjaj.
Orë letrare në nderim të manifestimit, lexuan poetët: Rrahim Sadiku, Lulash Brigja (Shkodër), Agim Desku, Idriz Berisha, Raif Gashi, Gjon Gjergjaj, Safet Hasani, Gani Bytyçi, Maxhun Osmanaj, Halil Xani, Ragip Kçiku, Ramë Thaçi.
Pas manifestimit në oborr të kullës ,pati ushqime tradicionale valle ,foto biseda bashkëpunimi Nder disa televizione që e përcjedhën aktivitetin po veçoj miqtë e mi të Tv FONTANA .me Zeqir Mehmetaj. Respekt për organizatorët dhe pjesmarrësit edhe pse pak larg dhe koha e pamjaftueshme per të shijuar bukuritë e bjeshkes ..ishte kënaqësi pjesmarrja...
Respekt .L.Brigja

**Prend Buzhala është me Ismet Krasniqi Lala dhe 3 të tjerë**

•

26lh qfiershoeru ntSgpfsumëol 9fl:md3doh0enust eMoDremed ·

Sot, DITA E PLISIT, EDICIONI VIII me radhë,
kësaj radhe në Stankaj të Rugovës, në kullën e Hysen Kurtajt (lahutar i njiohur. Manifestimin e drejtoi, ideatori Ismet Krasniqi Lala.
Promovim i vëllimit Dita e plisit" (vëllimi VII) i bashkautorëve Ismet Krasniqi e Prend Buzhala, ligjëroi: Safet Hasani.
Rapsodë: Rifat Berisha me grupun e tij, Gjon Krasniqi (diasporë, SHBA), Gjelosh Fusha (Shkodër) Nazmi Hajdari (Ferizaj).
Me lahutë: Hysen Kurti.
Valle rugovase: nga ansambli “Rugova”.
Kumtesë, Prend Buzhala: "Kulti i nderit në traditën shqiptare".
Mirënjohje nga Shoqata Atdhetare “Dukagjini” (Shkodër), Ndue Sanaj, Lulash Brigja, etj. Kjo shoqatë ndau mirënjohje për. Frrok Kristajn, Bajram Kelmendin (post mortum), dr. prof. Zymer Nezirin, Tahir Bezhanin, Sejdi Berishën, Gjon Gjergjajn.
Orë letrare në nderim të manifestimit, lexuan poetët: Rrahim Sadiku, Lulash Brigja (Shkodër), Agim Desku, Idriz Berisha, Raif Gashi, Gjon Gjergjaj, Safet Hasani, Gani Bytyçi, Maxhun Osmanaj, Halil Xani, Ragip Kçiku, Ramë Thaçi.
Pati edhe diskutime rreth manifestimit, po edhe rreth mohimit të trashëgimisë nga qarqe të jashtme e të brendshme, nga: Hysen Kurti, Rifat Berisha, Tahir Bezhani, Halit Barani, Gani Bytyçi, Safet Hasani, Ismet Krasniqi, Idriz Berisha etj.
Në fund: sofra me ushqime tradicionale e me valle nga ansambli “Rugova”.




DITA E PLISIT






# AKTIVITETET E AFA “RUGOVA” 2022

## PËRSHKRIMI

AFA Rugova gjatë vitit 2022 ka zhvilluar këto aktivitete dhe ate ;

| | |
|---|---|
| Festvale | 8 |
| Talme kulturore | 10 |
| Manfestime | 7 |
| Projekte | 3 |
| Inqizime | 6 |

### DITET E KULTURE PEJANE 26.03.2022

Teatri Istref Begolli Pejë







Ne nje atmosfere te mire pas shume shtyerjeve u mbajt mbremja e trete e Kultures Pejane nder vite – mbremja e folklorit me Rapsod dhe artist te AFA Rugova.

Mbremja u hape me fjalen pershendetese te Aver Husaj , Shef I Kultures prane DKRS duke I pershendetur Mysafiret e shumte . I pranishem ishte edhe studiuesi , publicist dhe shkencetari I Folklorit Dr. Xymer neziri nga Instituti Albanologjik Prishtine.

Nene skenarin e Dr Valdet Hysenaj dhe Regjizorit Fadil Grabovci, ishte punuar skena me motive te odes Dukagjinit, shtruar me qilima dhe orendi te odes.

Mbremja u udheheq nga adatari I mirenjohur Haxhi Rrahmani I shoqeruar nga Qerim Uka n te cilet se bashku me Rapsodin Rifat Berisha , e bene kete mbremje vertet sit e ndodhej ne oden e Dukagjinit , me te gjitha doket, zakonet dhe sielljet.



Mbremja u hap nga AFA Rugova me vallen e hyrjes    Florim Nikqi

Shaban Demaj dhe Vesel Nikçi shoqeruan me kenge malesorqe   Zhuj Selmani    qe  Hyri ne Skene te pergaditur nga Haxhi Rrahmani pritesi .
Pas vendosjes dhe uljes antareve te AFA Rugova,  Lahutari Ise Elezi e mori  kengen e Shemso Ferit
Rifat Berisha me Grupin e vete kendoj kengen e Hysen Bajrit
Nje vogelushe Klea Selmani recitoj  …. Rugove  te dua Rugove…
Ne Vazhdim  pasoj kenga e Avdyl Husit   me shoke, Bylbylat e Dukagjinit
Me pastaj  iu dha Rasti  nje vallezimi dyshe femrash dhe meshkuj nga AFA Rugova si valle gazmore apo



Fadil Grabovci  e freskoj oden me nje humor Dukagjinit  …. Puna mbare burra…

Shaban Demaj dhe rapsodet Beke Nikqi  e Naim Shkreli ia krisn kenges  Zhuje Selmani

Grupi I vajzave  te AFA Rugova , paraqiti para publikut dhe odes, kengen

N`drras te vekut kush po kjan perciell me tepsi

Rapsodi Besim Zabelaj , kendoj kengen e arshikise

Valle katershe nga grupi Ansamblit Rugova
Vazhdoj me ndarjen e  çmimeve **FOLKLORIT**

**Këto Çmime u ndanë nga DKRS   me nderim  dr Zymer Neziri**



## Çmimet Post- Mortum

1. **Prof. DR. Xhavit Aliçkaj - Instrumentist**
   Më motivacion, për kontributin e dhënë në ruajtjën , zhvillimin dhe begatimin e folklorit burimor .
2. **Haxhi Zhuti – Rapsod  në Shoqërinë Artistike - Isniq**
   Më motivacion, për kontributin e dhënë në ruajtjën, kultivimin dhe begatimin e trashëgimisë kulturorefolklorike.



3. **Sadik Harabataj Abazaj – Lahutarë , AFA “Rugova”**
   Më motivacion, për kontributin e dhënë në ruajtjën, kultivimin dhe begatimin e trashëgimisë kulturore folklorike.



4. **Bajram Ibish Nikqi – Rapsod, AFA “Rugova”**
   Më motivacion, për kontributin e dhënë në ruajtjën, kultivimin dhe begatimin e trashëgimisë kulturore folklorike.

5. **Shaban Muriqi – Vallëtar , AFA “Rugova”**
   Më motivacion, për kontributin e dhënë në ruajtjën, kultivimin dhe begatimin e trashëgimisë kulturore folklorike

6. **Gani Gashi - Këngëtar-instrumentistë dhe SHKA Ramiz Sadiku- Pejë**
   Më motivacion, për kontributin e dhënë në ruajtjën, kultivimin dhe begatimin e trashëgimisë kulturore folklorike.
7. **Halil Gashi- Aktor – Gazetarë**
   Më motivacion, për kontributin e dhënë në ruajtjën, kultivimin dhe begatimin e trashëgimisë kulturore tëartit skenik.

## Çmimet Karierës

1. **Raze Nikqi – AFA "Rugova"**
   Më motivacion, për kontributin e dhënë në ruajtjën, kultivimin dhe begatimin e trashëgimisë kulturore folklorike.
2. **Mehdi Berisha – Rapsod**
   Më motivacion, për kontributin e dhënë në ruajtjën, kultivimin dhe begatimin e trashëgimisë kulturore folklorike.
3. **Fadil Grabovci – Regjisor**
   Me motivacion, në kontributin e dhënë në ruajtjen kultivimin dhe begatimin e vlerave traadicionale në trashëgiminë kulturore

## Çmimet për vepër jetësore

1. **Vesel Nikçi - vallëtarë, AFA "Rugova"**
   Më motivacion, për kontributin e dhënë në ruajtjën, kultivimin dhe begatimin e trashëgimisë kulturore folklorike si dhe në organizimin pjesëmarrjës AFA ”Rugova”në festivale kombëtare dhe nderkombëtare .

Ne Fund Mbremja u mbylle me kercimin e Valles me Pisqole nga Florim Nikqi dhe Fatos Selmanaj



duke  e perciell pastaj vallene e trashegimise  Vesel Nikç tek Mentor Morina  me Jatagana



Gjithe kjo me perciellje te bukur tupanit dhe surles nga antaret Faton Bytyqi dhe Uke Kameraj
Falmndeojm me kete rast Baton Nezirin I cili e gjiroj  kete mbremje  si dhe  Granit Husaj Zerimi , Valdet Hysenaj  moderimi.
Falmnderim i veqant per TV Tontana   e cila  e transmetoj direct kete mbremje .

# Përfundon festivali ‘Hasi Jehon’

**Ansambli “Çeta e Profetëve” nga Kruma e Hasit të Shqipërisë fituese e edicionit të 32 te Festivalit “Hasi Jehon”.**

Me ndarjen e çmimeve ka përfunduar mbrëmë nata e tretë, nata finale e edicionit të 32 të Festivalit “Hasi Jehon”. Juria e përbërë nga Sami Piraj (kryetar i Jurisë), Asim Canolli, Hysen Dida, Dilaver Kryeziu dhe Muhamet Lushaj ka bërë ndarjen çmimeve tradicionale të Festivalit. Samir Piraj, kryetar i Komisionit tha në fjalën e tij se “Festivali ka arritur që të trajtojë probleme më esenciale të vlerave të trashëgimisë shpirtërore dhe asaj muzikore”.




“ Edhe ky edicion është spikatë me shumë karakteristika që e shenjëzojnë si një ngjarje të shënuar kulturore. Natyrisht, e ka pas shumë vështirë të qëndroj në ballë të problemeve të cilat janë praktikisht të pranishme në jetën tonë siç është Covid 19 dhe problemet tjera. Megjithatë ka shumë karakteristika që e shenjëzojnë si Festivalin unikat tash për tash në Kosovë dhe ky eveniment, kjo ngajrje kulturore shpresoj që të jetë pjesë e ruajtjes insttitucionale të trashëgimisë shpirtërore dhe materiale. E them për shumë arsye dhe njëra ndër to është

organizimi kaq dinjitoz i Ansamblit “Malësori” si gjenerator faktikisht realizues i këtij Festivali në krye me kryetarin Haziz Hodaj”
tha Sami Piraj.
Ai në vazhdim i shpalosi çmimet.
Çmimin “Malësori” e fitoi Ansambli “Çeta e Profetëve” nga Kruma e Hasit
Çmimi “Malësorja” iu nda për Ansamblin “Deçani” nga Deçani
Çmimi “Lahuta” iu nda Ansamblit “Bresana” nga Bresana
Çmimi “Nazmije Totaj” iu nda këngëtares  Mamure Belaj nga Kaçaniku
Ritali më objektiv Ansambli “Bresana” nga BresanaGrupi më i dalluar i rapsodëve nga “Hajvalia”  nga Hajvalia
**Kostumet autoktone  AFA  “Rugova ” nga Peja**




Koreografia më e mirë Ansambli “Bajram Curri” Prishtinë
Grupi më i mirë i vallltarëve “Anamorava” Viti
Dyshja më e mirë e valltarëve dyshja e Ansamblit “Deçani” nga Deçani
Vallatarja më e mirë Rilindë Gjonbalaj “Vuthaj” Mal i Zi
Valltari më i mirë Fahri Musa nga Ansambli “Anamorava” Viti
Rapsodi më i dalluar Përparim Brati nga Kruma
Orkestra më e dalluar “Bajram Curri” Prishtinë
Instrumentisti i dalluar I takon Muharrem Dibrës nga Kruma e Shqipërisë./**KultPlus.com**

# Sofra Dardane, edicioni i 19-të në Tropojë, bën bashkë me qindra artistë nga trojet shqiptare

Nga OraNewsPërditësimi i fundit 13 Qershor 2022, 16:13

Flamuri Kombëtar i printe, kur u mblodhën në qytetin e Bajram Currit për edicionin e 19 të Sofrës Dardane



Sofra e artit mbushi stadiumin e hapur të lojërave me dorë me qindra artistë nga trojet shqiptare. Mbartës dhe përcjellës të traditave më të mira popullore shqiptare'

*"Ku shpalosen vlerat e të gjitha trevave shqiptare. Këtu kemi nga Plava, Gucia, Korça, nga Vlora."*

## Festivali  Rapsha", Malësia e Madhe

Shka Rapsha Vitoje ,gjegjësisht si nikoqire edhe njëherë u dëshmua se din dhe mundet të organizojë festivale më të mira se dy kryeqytetet shqiptare, madje pa e shti dorën buxhetet institucionale. Edhe njëherë u dëshmua se shpirti motivues i një shoqërie , por edhe hapja e kuletës e mërgimtarëve tanë tej Atlantikut, është në gjendje të vejë në lëvizje me dhjetëra trupa folklorike dhe me qindra artistë nga gjitha trojet etnike, duke pas për tri net rresht një numër rekord artdashës,- Dorën në zemër edhe juria sado profesionale nuk e ka pas lehtë të përzgjedh artistët apo grupet më të mira, pasi që kishte para vetës një mori ansamblesh, moshash të ndryshme nga shumë zona të trojeve shqiptare, mjaft nga të cilat edhe në kushtet e një zhvillimi të hovshëm tekniko-

teknologjik kanë arritur të ruajnë një trashëgimi shumë të pasur etno-folklorike




RAPSHA 2022




FESTIVALI MBARËKOMBËTAR I FOLKLORIT
“RAPSHA 2022” - MALËSI E MADHE
MIRËNJOHJE
ANSAMBLI AUTOKTON "RUGOVA" RUGOVË, PEJË
për pjesëmarrje dhe kontribut në ruajtjen
dhe kultivimin e vlerave kulturore
Vitojë
FESTIVALI
MBARËKOMBËTAR I FOLKLORIT
“RAPSHA 2022” - MALESI E MADHE
VITOJË
19-21.08.2022
Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore, Pejë
VISARE TË TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
TË PEJËS ME RRETHINË, II
ANSAMBLI FOLKLORIK AUTOKTON
RUGOVA
THESAR I TRASHËGIMISË
KULTURORE SHQIPTARE
DRUME | HOT | MALËSI E MADHE
Shoqëria kulturore - artistike
RAPSHA
40-vjetori i veprimtarisë
Tuz, Malësi e Madhe
2018

- RUDINA FEST” Festivali i madh që ka mbledhur 15 ansamble fillon nesër në Çegran




Kulturë

# ”RUDINA FEST” Festivali i madh që ka mbledhur 15 ansamble fillon nesër në Çegran

July 19, 2022Bonzo Admin

Festivali nderkombetar folklorik “RUDINA FEST” sivjet shënon edicionin e dytë, duke e shëndruar këtë festival në tradicional që të organizohet për çdo vit. Festivali do të zhvillohet gjatë periudhës 20, 21, 22 dhe 23 Korrik në disa lokalitete, duke filluar nesër më 20 Korrik nga Çegrani nga ku e ka zanafillën dhe emërtimin e tij, pastaj më 21 Korrik në Forinë, më 23 Korrik te Amfiteatri veror në Gostivar dhe më 23 Korrik nata finale gjegjësisht përmbyllja e festivalit tek parku i madh i qytetit në Gostivar. Gjatë këtyre katër netëve do të marrin pjesë rreth 15

Ansamble dhe grupe folklorike nga 9 shtete të ndryshme, ku në skenë do të ngjiten rreth 400 artistë të cilët do të shfaqin artin, kulturën dhe traditat e vendeve të tyre përkatëse prej nga vijnë. Risi e edicionit të dytë të festivalit RUDINA FEST është pjesëmarrja e një Ansambli nga Amerika Jugore gjegjësisht shteti i Chiles të cilët përpara publikut do të shfaqin folklorin dhe kulturën amerikano-latine.



Gjithashtu Moldavia, Ukraina, Turqia, Mali i Zi, Bullgaria, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia V. do të jenë pjesëmarrëse në këtë festival. Përveç mbrëmjeve me program të pasur artistik, nuk do të mungojnë defiletë e artistëve me kostumet e tyre tradicionale

RUDINA FEST 2022
Në natën finale më 23 Korrik komisioni artistik i vlerësoi grupet artistike dhe ndau çmime speciale për ansamblet pjesëmarrëse:
🥇🇲🇩Ansambul ”Romanita” nga Moldavia për afirmimin më të mirë skenik dhe vokal të traditës moldave
🥇🇧🇬Ansambli “Hemus” nga Bullgaria për performancën më të mirë skenike dhe afirmimin e kostumeve tradicionale origjinale
🥇🇨🇱Bafpu ballet folklórico de Pućon nga Kili për performancën skenike më dinamike dhe afirmimin e traditës së gjallë vokale dhe muzikore
🥇🇲🇪SHKA “Dečiči” nga Mali i Zi për ansamblin më të ri dhe solistët më karizmatikë
🥇🇺🇦Ansambli “Polisianocka” nga Ukraina për ansamblin më të mirë të të rinjve
🥇🇽🇰Ansambli “Rugova” Kosovë për shfaqjen më autentike skenike




🏅🇹🇷Ansambli “Birlik” Kosovë, për kostum origjinal mashkullor me origjinë turke
🏅🇽🇰Ansambli “Deçani” Kosovë, për kostum femëror origjinal me origjinë shqiptare
🏅🇦🇱Ansambli “Kaltërsia” Shqipëri për interpretim dhe transmetim të muzikës tradicionale tek brezat e rinjë
🏅🇲🇰A.F “Kitka” Istibanja për shfaqje skenike origjinale
🏅🇽🇰G.K. “Mirela” Kosovë për interpretim muzikor
🏅🇲🇰A.F. “Bojmija” Gjevgjeli për shfaqje skenike dinamike të një vepre koreografike
🏅🇲🇰Studio "Blazevski" Shkup, për kostum popullor përkatës në vepër koreografike
🏅🇲🇰Ansambli "Makedonija" Shkup, për shfaqjen më autentike skenike



# Malësia e Madhe mirëpret 60 lahutarë të moshave të ndryshme

Nga
**Etleva Xhajanka**
-
28/09/2022




TIRANË, 28 shtator /ATSH/ Bashkia e Malësisë së Madhe mirëpret sot rapsodë dhe instrumentistë popullorë nga të gjithë trevat shqipfolëse, në aktivitetin "Takimi i lahutarëve shqipfolës".
Tonin Marinaj, kryetari i bashkisë Malësi e Madhe tha se, ky aktivitet kulturor organizohet për herë të parë, me pjesëmarrjen e lahutarëve nga të gjitha trevat e Shqipërisë.

“Takimi i lahutarëve shqipfolës”, i kushtohet rapsodisë dhe lojës me lahutë, që është një ndër veglat popullore muzikore më të njohura.




Në këtë aktivitet marrin pjesë mbi 60 artistë popullorë të moshave të ndryshme. Nga juglindja, në verilindje e veriperëndim. Janë mbledhur së bashku lahutarë nga Kurbini, Hasi, Kukësi, Lezha, Mirdita, Malësia e Madhe, Vau i Dejës, Shkodra, Lezha, Mallakastra, Rugova, Mati, Kamza, Gostivari etj. Dallohet pjesëmarrje edhe e talenteve të reja që i bien lahutës dhe kanë mbërritur nga Shkodra e Lezhës.
“”Takimi i lahutarëve shqipfolës” është një ndër të parat veprimtari e këtij lloji që i adresohet muzikës me lahutë. Organizmi i këtij aktiviteti ka për qëllim të ripërtërijë traditën e trashëgiminë folklorike si pasuri kombëtare që ruhet e zhvillohet në trojet shqiptare, por edhe jashtë kufijve shtetërorë si Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Greqi e Diasporë”, tha Marinaj.

# Shoqata Bashkimi Uster

E shtunë 19. Shkurt 2022
Ishte e shtunë 19. Shkurt 2022 kur në Aeroportin e Zürichut e pritëm një delegacion të vogël të **Ansamblit Folklorik Autokton RUGOVA, Florim Nikqi dhe Fadil Grabovci.**
Pasi që nga Autoritetet e komunës na u anulua aktiviteti i pavarësisë së Kosovës ne e pamë të arsyeshme ta qojmë deri në fund marrëveshjen e bashkëpunimit tonë.
Me një pjesë të kryesisë së Shoqatës Bashkimi ne i pritëm përfaqësuesit e AFA RUGOVA



në ambientet e Shoqatës sonë.
Florim Nikqi dhe Fadil Grabovci në shenjë falënderimi dhe bashkëpunimi na dhanë mesazhet e ngrohta nga drejtuesit e AFA RUGOVA, gjithashtu nga vetë Ansambli Folklorik Autokoton RUGOVA ne na u dhurua një Tupan të cilin e kanë përdorur vetë AFA RUGOVA, një dhuratë shumë e çmuar për ne.
Pasi u nënshkrua marrëveshja për bashkëpunim ne biseduam për të ardhmen dhe bashkëpunimet e rradhës, i kujtuam edhe bashkëpunimet e shkuara ku kemi kaluar çaste të paharruara së bashku.
Ju faleminderit Ansambli Folklorik RUGOVA për vizitën tuaj në Shoqatën BASHKIMI.

# Trashegimija jonë material dhe shpirterore sipas gojëdhënave

Gojëdhënë

Kallëzim popullor për një ngjarje të së kaluarës, për një figurë historike etj., që mund të ketë një bazë të vërtetë, por që është shtuar e zbukuruar nga fantazia e popullit dhe përcillet gojë me gojë nga njëri brez në tjetrin; legjendë.
Në një të kaluar shumë të largët historike, Ballkani në përgjithësi ka qenë i mbuluar me ujë, fillimisht me det e më pastaj edhe me ujë të ëmbël ose liqen, përfshirë këtu edhe territorin e sotëm të Kosovës. Ndoshta mund të duket e pabesueshme, por kronika në vazhdim sjell dëshmitë që koha ka ruajtur nga ajo periudhë.
Guaskat e gjetura në pjesë të ndryshme të Kosovës e shtresimet liqenore, janë argumentet më të mira që dëshmojnë që Kosova dikur ka qenë e mbuluar me ujë.

# Peja- vendebanimet antike

## Shpella e Radavcit (Bukuroshja e Fjetur)

.

Shpella e Radavcit (Bukuroshja e Fjetur) gjendet afër fshatit Radavc, ne pjesën verilindore të vargmaleve të Alpeve Shqiptare (Bjeshkëve të Nemuna) dhe është shpellë tipike e burimeve.
Formimi i saj është i lidhur me erozionin dhe punën kimike të ujërave nëntokësore të Drinit të Bardhë. Kjo shpellë përbëhet prej katër elementeve morfologjike: galeritë kryesore, galeritë e majta, galeritë e poshtme dhe kanalet vertikale. Gjatësia e përgjithshme e të gjitha kanaleve të shpellës së Radavcit është 1420m, ndërsa kanalet horizontale janë të gjata 680m.
Galeria kryesore përbehet prej tri pjesëve: kanalit hyrës, galerisë qendrore dhe kanalit të vaskave. Salla qendrore fillon rreth 55m dhe paraqet një udhëkryq të rregullt. Nga këtu nisen tetë korridore dhe kanale të cilat në nivele të ndryshme lidhen me galerinë fqinje. Fundi i sallës shtrihet 14m mbi lartësinë e hyrje së shpellës.
Në pjesën qendrore të sallës gjendet një shtyllë kristalore e lartë 12m. Karakteristikë për këtë shpellë është kanali me vaska i cili gjendet në vazhdimin e galerisë qendrore. Gjatësia e saj është 76m, gjerësia prej 4–8m dhe lartësia në mes 3-5m.

## Shpella "Gryka e Madhe ]

Shpella “Gryka e Madhe“ ndodhet në kilometrin e tetë të Grykës së Rugovës, në anën e majtë, 60 m mbi shtratin e lumit (Lumëbardhi i Pejës), në lartësinë mbidetare 637m.

Shpella e madhe

Hulumtimet në shpellën “Gryka e Madhe” kanë filluar në maj të vitit 1992, nga pesë speleolog Sllovak, edhe pse kjo shpellë ka qenë e njohur nga banorët lokal që prej kohe. Më 29 tetor 1995, një grup prej katër speleologesh, pas një pune pesë orësh në heqjen e gurëve prej burimit të poshtëm të ujit (i cili këtë herë ishte i thatë) arritën që të futeshin në pjesën e poshtme të shpellës ku hasën në një lum të brendshëm. Në hyrjen (pak më lartë-hyrja kryesore), në të cilën nuk kishte ujë që ti pengonte, ekipi arriti të futej në brendi të shpellës disa qindra metra. Në kanalin kryesor të shpellës ata zbritën në rrjedhën e lumit nëntokësor, dhe poashtu u ngjitën në disa oxhaqe të errëta dhe të larta. Ekspeditat hulumtuese të speologëve sllovak vazhduan edhe në vitet 1996-2007 me një ndërprerje në periudhën 1998-2001. Gjatë ekspeditës 10 ditore (shkurt 2007), ekipi i speologëve arritën që të vënë në hartë profilin, planin rreth 8-km të korridoreve të shpellës në një plan me përmasa 1:200.

Harta e shpelles se "Grykes se madhe"

Nivelet më të larta të shpellës nuk kanë sedimente por janë me fundërrina të rërës, ndërsa në nivelet më të ulëta mund të gjejmë gurë të rrumbullakët dhe të mëdhenj, të cilët janë shembur

nga muret e shpellës. Në shpellë deri më tani janë hulumtuar pesë nivele. Niveli i parë është niveli i lumit i cili është mjaft aktiv. Ky nivel arrin lartësinë prej 66m prej hyrjes. Ka një shkallëzim dinamik dhe vende-vende shumë i rrezikshëm. Nga ky nivel mund të zbritet në shtratin e lumit, përmes disa kanaleve te ngushta në formë të gypave të pjerrtë... Këtu hasim në sedimente apo fundërrina shumë-ngjyrëshe. Niveli i dytë shtrihet mesatarisht 15–20 m përmbi rrjedhën aktive të lumit nëntokësorë.Në pjesën e parë të shpellës këto dy nivele janë te lidhura në mënyrë simetrike me një kryqëzim tre-dimenzional te disa kalimeve te vogla dhe disa lidhjeve, te cilat nuk janë te hulumtuara deri në fund gjer më sot, dhe po ashtu nuk janë te futura ne hartë (të ashtuquajturat “Kalimet e Gjarprit”). Një pjesë e veçantë dhe unike e shpellës është edhe i ashtuquajturi-Tobogani, me kohë janë krijuar edhe ngushtica të mrekullueshme, të gjëra deri në 1m dhe të thella deri në 2m. Një fakt i çuditshëm në këtë shpellë është se deri sa në pjesën e parë mungojnë dekorimet, në hyrje të shpellës, pjesa tjetër, pas gjysmë-sifonit, është për mrekulli e dekoruar, me të gjitha llojet e mundshme të speleo-dekorimeve. Këtu ka shtylla të mëdha dhe të larta, deri në disa metra të gjatë, stalaktite, perde e draperi të gjata, stalagmite të grumbulluara, penda të vogla nga shkëmbinjtë, liqeje me kristale dhe margaritar nga kalciti.

Zhvillimi urban i Pejes ka kaluar neper periudha te ndryshme historike, duke filluar nga kohet me te hershme gje qe deshmohet nga trajtat e thirrjeve. Ne literaturen e deritanishme ne lidhje me emertimin e Pejes ekzistojne disa periudha te emertimeve, ajo antike dhe ajo e mevonshme. Emertimin Siparantum e gjejme te Ptolemeu (87-150) ne vepren e tij "Gheographia" qe e mbeshtesin edhe shume historian, arkeolog, gjeograf, publicist etj. Siparantumi sipas burimeve arkeologjike-antike ishte ne rang te "Muniupiumit", (qytetit) per ndryshe lokaliteti i dyte me rendesi ne teritorin e Kosoves pas Ulpianes. Procopi Caesariensis historian i bizantit (v. 565) jep pershkrime per lokalitetin e shenuar si Pentza qe zevendesoi emertimin si Siparantum e qe me vone merr trajten Pek-Pekia-Peja. Teritori i Pejes ka qene gjate historiatit te vete se pari pjese e Dardanise Ilire, pastaj ne kuader te Romes, Bizantit (Campus Dardanci) ne mesjete te Serbise, e me vone te Perandorise Turke. Vendbanimi antik i Pejes perjetoi pertrirjen e saj gjate kohes se Dioklecianit, kur u shtua ne nje mase te konsiderueshme procesi i romantizmit. Per historine antike te Pejes rendesi te madhe ka pasur vendbanimi antik ne lokalitetin "Gradina" qe padyshim paraqet vazhdimsine e vendbanimit te meparshem Dardan, qe ka vazhduar te ekzistoj edhe gjate shekujve te pare te sundimit Romak. Kur eshte fjala per termin Gradine-a kjo eshte thirrje e paster Ilire qe ka gjetur perhapje te gjere nder gjuhet Latine, Gjermane dhe Sllave. Vee materialit epigrafik ne kete vendbanim eshte zbuluar edhe nje numer objektesh arkeologjike qe na shtyjne te konstatojme se ketu duhet te kete qene nje qender administrative municipiale e terr Rrafshit te Dugagjinit. Ne qendren e ketij materiali me se shumti ne menyre reprezentative jane monumentet mbivarore-stelat, e te ashtuquajturit tip Dardan. Onomastika Ilire ne Dardani ka qene autoktone dhe jo e marre nga jashte, eka deshmojne edhe emrat dhe mbiemrat e gravuruar ne stelat e zbuluara ne treven e Pejes qe drejtpersedrejti deshmojne pranine dhe kontinuitetin e popullsise se trungut Ilir.

---

Nder dukurite me te rendesishme qe shoqeron kthimin ne mesjete ishte perhapja e krishterimit. Krishterimi hodhi rrenje ne treven e Dardanise qysh ne shekujt e pare te eres sone. Pas ndarjes se perandorise Romake ne dy pjese Peja hyri ne teresi ne kuadrin e perandorise Bizantine (shek. VI) ne kohen e perandorit Justinian. Ne fillim te shekullit VII ne aleance me Avaret depertojne ne keto vise edhe sllavet. Me rastin e vendosjes se tyre ne kete

rajon, sllavet gjeten banoret e hershem - Dardanet e Romanizuar dhe te krishterizuar. Dardania si province ekzistoi deri rreth shek. IX kur dhe u shkatrua si pasoje e humbjes se pjeseve veri-perendimore prej rashkaneve.
Per Pejen ne feudalizmin e hershem (shek. V-XI) nuk kemi shume te dhena te shkruara dhe materiale Per fazen e feudalizmit te hershem kemi te dhena se ne Peje po ne kete kohe shfaqet prodhimtaria intensive agrare se bashku me blegtorine ne viset e saja malore. Qyteti ne shek. IX organizohej ne tema (organizim administrativ) dhe ka te ngjare qe edhe qyteti i Pejes te jete i organizuar ne teme. Ne Perandorine e Bizantit organizimi kishtare shtrihej mbi organizimin administrativ i cili bazohej ne qytetin, prandaj edhe selia e peshkopeve perputhej me konceptin qytet. Gjate shekujve XI dhe XII, trojet e Kosoves ishin arene konfliktesh ndermjet ushtrise Bizantine dhe asaj Serbe. I biri i Stefan Nemanjes, Stevan Prvovenganin (1190-1228) perfundimisht futi ne dore te gjitha trojet e Kosoves. Bizanti e njohu zyrtarisht shtetin Serb. Gjate sundimit serb kisha ortodokse serbe beri ndikim mbi popullsine shqiptare qe ajo te merrte antroponomi te provinces sllave dhe i ndrroi ose i pershtati toponimet shqipe ose jo sllave. Ajo edo gje qe ka qene e fese ortodokse, e ka konsideruar serbe. Te dhenat e dokumenteve kishtare serbe te mesjetes (krisobulat e Deeanit) deshmojne qe para formimit te kishes serbe ne Kosove, kishte kisha greko-latine e Bizantine, qe me kohe serbet, pervetesuan dhe filluan te sundojne permes tyre popullsine shqiptare. Peja si qytet permendet qe nga viti 1202, gjate periudhes se feudalizmit te zhvilluar, kurse ne karten e Stevan Prvoveneanit (rreth vitit 1215) permendet si fshat ne rrafshin e Hvosnos. Kah fundi i shek. XIII permendet si "Pek" dhe "Pek arhiepiskupova". Ne shek. XIV Peja permendet nga Raguzanet dhe Kotoraset qe shkonin per te tregetuar ne Peje "In Pecho", kurse ne vitin 1378 permendet karvani "In novam montem Pech et Prisrenu". Te dhenat historike rreshtojne se Peja me rrethine pas betejes se Kosoves 1389 e deri me 1462 administrohet njehere nga Balshajt e pastaj nga Dukagjinet. Qe Balshajt ishin shqipetar deshmojne si bashkohesi Konstatin filozofi ashtu edhe shume burime tjera.

Këto janë 10 bestytnitë interesante që shqiptarët ende besojnë në to

**Besëtytnitë padyshim që janë pjesë e çdo populli, dhe për to ende dëgjohet të flitet edhe tek shqiptarët.**

Por, cilat janë 10 besëtytnitë që shqiptarët ende i besojnë?

**Më poshtë kemi radhitur 10 nga besëtytnitë që disa njerëz ende i besojnë:**

**Kur macja e zezë "të pret" rrugën**

Nëse duke e kaluar rrugën, qoftë në këmbë apo me veturë, një mace e zezë ua 'pret' rrugën, atëherë ju duhet ta ndryshoni drejtimin apo të ktheheni, pasi kjo është një shenjë e fatkeqësisë. Në mesjetë, macet konsideroheshin kafshë të shtrigave, kështu për të mos pësuar ndonjë fatkeqësi, ato edhe vriteshin.

**E martja 'e zëzë'**

Mendohet se e marta është dita kur Zoti krijoi të ligën, kështu, sipas më të vjetërve, nuk është mirë që të pastroheni natën e martë, të punoni punë dore apo punë të tjera.

**Prerja e thonjve natën**

# Panairi i librit “Diaspora 2022” në Uster, me risi dhe autorë të shumtë

Guximtar Alushi: "Në këtë panair do të kemi rreth 33 shkrimtarë dhe 4 shtëpi botuese që vinë nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut". Platforma mediale albinfo.ch është partner medial në panairin e edicionit të sivjetëm të librit: "Diaspora 2022"




Të dielën, me datë **18 shtator 2022**, nën organizimin e Shoqatës “Bashkimi” në Uster të Kantonit të Zyrihut u organizua Panairi i Librit “Diaspora 22”. Një organizim që la “pa fjalë” shumë pjesëmarrës, të cilët shprehën fjalët më të bukura për organizimin dhe skenarin e Panairit.

## Vaxhid Sejdiu: Libri solli ditë feste në Uster të Kantonit të Zyrihut



www.radiokosovaelire.com/vaxhid-sejdiu-libri-solli-dite-feste-ne-uster-te-kantoni…

Was this helpful?

- **[Zvicër/Panairi i librit “Diaspora 2022”,aktivitet i mrekullueshëm i ...]**

https://ina-online.net/zvicer-panairi-i-librit...

21/09/2022 · Publikuar më Sep 21, **2022** Shpërndaje Shoqata Kulturore Shqiptare “Bashkimi” në Zvicër organizoi këtë të diel në qytetin Uster **panairin** e **librit “Diaspora 2022”.** Një aktivitet unik …




- **News about** Panairi Librit Diaspora 2022

bing.com/news

Panairi i librit “Diaspora 2022” në Uster, me risi dhe autorë të shumtë

Guximtar Alushi: "Në këtë panair do të kemi rreth 33 shkrimtarë dhe 4 shtëpi botuese …




U mbajt panairi i librit “Diaspora 2022”

Pos librave të shumtë në gjuhën shqipe, të pranishmit patën mundësi të ndjekin edhe një performancë artistike, ritmet e valleve krijuan një atmosferë të këndshme ...

albinfo · 6d

- **Panairi i Librit Diaspora 2022 - KultPlus**

https://www.kultplus.com/tag/panairi-i-librit-diaspora-2022

Vinca: Libri është baza e qytetërimit Posted on 22 Shtator, 202222 Shtator, **2022** by Kult Plus
Është mbajtur Panairi i 2-të i **Librit "Diaspora 2022"** në qytetin Uster të Zvicrës. Në hapje të …




- **[Me](#) Ambasadorin e Republikes Kosoves Zvicer**

https://diasporashqiptare.al/2022/09/20/zvicer...

20/09/2022 · Zvicër/Panairi i librit **“Diaspora 2022”,aktivitet** i mrekullueshëm i librit shqip Nga Gazetar 08:34 | 20/09/2022 Shoqata Kulturore Shqiptare “Bashkimi” në Zvicër organizoi këtë të …

- **Images of Panairi Librit DIASPORA 2022**

bing.com/images

Pikëtakimet e mija në panairin e librit me mërgimtarë, shkrimtarë e artistë
Panairi i sotëm i librit në qytetin e Usterit të kantonit të Cyrihut në Zvicër, me pjesëmarrjen e qindra mërgimtarëve si dhe shkrimtarëve e botuesve jo vetëm nga mërgata por edhe trojet etnike ishte rast i mirë për tu njoftuar jo vetëm me botime të reja por edhe piktakim krijuesish me mërgimtarë, që sjelli miqësi dhe njohje me interes jo vetëm për kulturën por edhe komunitetin tonë të madh në Zvicër.
Me këtë rast po sjelli atmosferën por edhe pikëtakimet e mija me miq, krijues e artistë




Shpresojmë shumë që të na bashkëngjiten afarist që veprojnë në Zvicër për të dhënë kontributin e tyre vetëm që ky panair që nuk është as politik dhe as fetar të mbijetojë ndër vite, kështu edhe gjeneratat pas nesh do të kenë me çfarë të mburren dhe do të jenë më të sukseshshëm.
Panairi “Diaspora 2022” realizohet vetëm me mjetet e shoqatës “Bashkimi” në Uster e cila falë anëtarësisë ende ka fuqinë ta përballojë realizimin e një eventi të tillë.
Institucionet tona në Zvicër janë gjithmonë të informuara rreth aktiviteteve tona, gjithashtu të tri ambasadat, ajo e Shqipërisë, e Kosovës dhe e Maqedonisë po ashtu edhe Kosullata në Zürich janë të

ftuar të na vizitojnë.




RUGOVA


ZANA
E SHËN
MARTINIT
Shkolla Shqipe
Uster
RUGOVA


RUGOVA


Panairi i 2të
i Librit
Diaspora
2022
ZANA
E SHËN
MARTINIT


"Shkolla Shqipe" - Zvicër
Dr. Vaxhid Sejdiu
RUGOVA
litera


ZANA
E SHËN
MARTINIT
Roman
Shkolla Shqipe
Uster
RUGOVA


RUGOVA


DARDANIA


RUGOVA
75 VJETORI
RUGOVA
PANAIRI I LIBRIT DIASPORA 2022 USTER ZVICER
18.09.2022
Ansambli Autokton
"Rugova"


ZANA
E SHEN
MARTINIT


RUGOVA
RUGOVA


RUGOVA

# SHOQATA SHQIPTARE NË PREFEKTURËN E ZARËS

## *Ditët e kulturës sonë kombëtare*

Me rastin e Ditës së flamurit tonë kombëtar, shoqata jonë kulturore, fton menaxherin
**Fadil Grabovci** që të mari pjesë në manifestimin kulturor e tradicional, me prezantimin e veshjeve tona kombëtare, valleve, lojrave tradicionale dhe riteve të tjera shqiptare nga treva e Rugovës dhe Dukagjinit.
Këtij grupi do ti bashkangjitet edhe grupi folklorik i shkollës shqipe të Arbanasit "Iliria" si dhe nxënës të tjerë të shkollave të mesme të Zarës në Dalmaci. Manifestimi do të jetë i përbashkët edhe me Arbëneshët e Zarës ku do të ketë edhe vizita dhe bashkëbisedim nëpër lagjet e tyre me plot emra dhe toponime shqiptare.
Një pjesë e e këtij aktiviteti kulturorë do të mbahet ne Bibliotekën "Aleksandër Stipçeviq" të Arbanasit, si promovimi i librit "Ansambli Folklorik Autokton –Rugova" (Visare të trashëgimisë shpirtërore të Pejës me rrethinë, II), me rastin e 75 vjetorit të kësaj trashëgimije.
Këti aktiviteti do ti bashkangjesim edhe vizitat kulturore në qytetin e Zarës si në Muzeun Arkeologjik të qytetit, Muzeun e Arit dhe Argjendit pran kishës së Shën Mërisë, varrezën e Vinçenc Zmait, Josip Relës, mësuesit Niman Ferizit etj.
Manifestimi mbahet me 25 Nëntor 2022, ora 15:00
si dhe më 26 Nëntor 2022, ora 18:00
Rekomandim shtesë:
Mundësohet pjesëmarrja deri në 6 (gjashtë) persona akter dhe staf përcjellës. Shpenzimet e udhëtimit i heq grupi pjesëmarrës. Akomodimi dhe udhqimi dy ditorë ndahet në 50% për grupin dhe organizatorin.
Sallën, teknikën përcjellëse, organizimin rreth manifestimit dhe vizitat tjera në muzet e qytetit i heq dhe i orienton

## SHOQATA SHQIPTARE NË PREFEKTURËN E ZARËS

# "DITET E KULTURES SHQIPTARE"

### Zare - Kroaci 2022




PROMOVIMI I MONOGRAFISË PËR PUNËN DHE AKTIVITETET ME RASTIN E 75 VJETORITTË ANSAMBLIT FOLKLORIK AUTOKTON "RUGOVA" PEJË





VALLE NGA ANSAMBLI "RUGOVA" , KËNDIM, VESHJE, TRADITË, LOJRA DHE DOKE






VIZITË OBJEKTEVE DHE MONUMENTEVE TË KULTURËS, NJOHJE MË TRADITEN E ARBËRESHEVE, SHKOLLEN SHQIPE DHE AKTIVITETE TË TJERA ME SHQIPTARET E ZARËS

25 dhe 26 Nentor 2022






# N± Rozhaj± u mbajt Manifestimi tradicional Kulturor òOra e Maleveò

## Më 16 prill 2022 në Rozhajë u mbajt Manifestimi tradicional Kulturor " Ora e Maleve" manifestim ky që u kushtohet vrasjes së refugjatëve kosovar në Mal të Zi.

18 Prill, 2022

0




Më 16 prill 2022 në Rozhajë u mbajt Manifestimi tradicional Kulturor " Ora e Maleve" manifestim ky që u kushtohet vrasjes së refugjatëve kosovar në Mal të Zi.
Në njëzet e tre vjetorin e vrasjes së të përndjekurve nga Kosova në fshatin Husaj të Rozhajës, krim ky që u shkaktua nga forcat ushtarake serbo- malazeze, në prill të vitit 1999, organet e drejtësisë në Mal të Zi nuk ka luajtur nga pika zero e hetimit dhe as që ka denuar kënd nga të dyshuarit për ketë krim makabër.
TE DYSHUARIT PËR VRASJEN E REFUGJATEVE KOSOVAR NUK U DENUAN KURR



# Kristaq F. Shabani

·

Ju kujtojmë: Manifestim i madh mbarëbotëror
Anëtaret dhe anëtaret e LNPSHA " PEGASI" ALBANIA duhet të jenë prezente .Është detyra e tyre ligjitime për pjesëmarrje aktive...
Pjesëmarrësit në Manifestimin "100.000" POETËT, ARTISTËT E BOTËS PËR NDRYSHIM "PEGASI INTERNACIONAL ALBANIA, më datën24.09.2022, ditën e shtunë, ora 11.00, në sallën e Akademisë së Shkencave Tirane, ku do të zhvillohet ky manifestim, duhet të kenë me vete:
*Poetet dhe poetët një poezi të tyre të rangut antologjik me objektin e përcaktuar; Shkrimtarët dhe shkrimtaret një skicim, ese;
Artistët dhe artistet një pikturë të tyre.
Gjithashtu, të gjithë autorët të sjellin disa nga librat e tyre për Ekspozenë e librit... Janë të ftuar ata, ato, që u është dërguar lajmërimi...

# Vesel Nikçi

Në Akademin e Shkencave të Shqiperisë Ansambli Folklorik Autokton Rugova u nderua më çmimin jetsore nga Akademia "Pagasi "Albania.


LIDHJA NDËRKOMBËTARE E POETËVE , SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE "PEGASI" ALBANIA
THE INTERNATIONAL ASSOCIATION OF POETS, wRITERS AND ARTISTS "PEGASI" ALBANIA
PRESIDENCA E LIDHJES NDËRKOMBËTARE E POETËVE SHKRIMTARËVE
DHE ARTISTËVE "PEGASI" ALBANIA

**AKADEMIA ALTERNATIVE PEGASIANE**

Prot . Nr. 59/150 TIRANË, 31 JANAR 2021

I JEP "ÇMIM JETËSOR
PËR VEPRIMTARI ARTISTIKE E KULTURORE :
ANSAMBLIT AUTOKTON "RUGOVA" KOSOVË,
ANSAMBËL 74 VJEÇAR, ME KONTRIBUT TË SHQUAR
NË ARTIN E MADH FOKLORIK TË KOMBIT

ME MOTIVACIONIN :

"I SHQUAR NË FUSHËN FOLKLORISTIKE PËR MBI SHTATË DEKADA, DUKE PASQYRUAR E TRANSMETUAR TRADITËN E BOTËS SË ZJARRTË SHPIRTËRORE TË KOMBIT E DUKE QENË PARAPRIJËS NË KËTË FUSHË TË NDRITSHME BEZIVE JETËSORE " .

PRESIDENCA E LIDHJES NDËRKOMBËTARE TË POETËVE , SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE "PEGASI" ALBANIA

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Dr. HEKURAN RAPAJ
STUDIUES, ANALIST

SEKRETARI I AAP
Dr. BEXHET ASANI
STUDIUES, PUBLICIST

PRESIDENTI
Prof. KRISTAQ F. SHABANI IWA, WPS, AOM, IBC, ABI
POET, SHKRIMTAR, STUDIUES, ESTET
"Njeriu i Vitit 2011" ABI, Kandidat për Çmimin NOBEL"për Paqen viti 2017


AKADEMIA E SHKENCAVE
E SHQIPËRISË




REPUBLIKA E SHQIPERISE
AKADEMIA E SHKENCAVE

**Jeta Beqiraj**

Me orën letrare “Epopeja e Dukagjinit”, të hënën Komuna e Deçanit filloi aktivitetet kushtuar fillimit të betejës frontale të Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës, në Dukagjin, si dhe fillimin e ndërhyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë. Aktiviteti letrar i mbajtur në sallën e asamblesë komunale në Deçan e në të cilin morën pjesë shkrimtarë të mirënjohur nga Kosova dhe Shqipëria, u hap me poezinë e Jusuf Gërvallës, “Tash po nisem”, interpretuar nga regjisori I mirënjohur Pandi Dukaj. Kryetari I komunës Bashkim Ramosaj,iu uroi mirëseradhje shrimtarëve duke I infromuar ata për vlerat e shumëfishta kulturore, natyrore dhe historike të komunës së Deçanit.
Programin me poezitë e tyre begatuan: Besnik Mustafaji, Flora Brovina,Entela Kasi,Alma Jaku, Klejda Plangarica,Prend Buzhala,Ajete Povataj,Esaj Loshaj,Idriz Berisha,Sofe Rizaj,Fatmire Qorraj,Fadil Dervishaj,Ali Geci,Tahir Bezahni,Rexhep Shahu,Izet Duraku,Ahmet Prençi,Agim Bajrami, Vladimir Muça dhe Hamdi Hysuka.




Në vazhdën e aktiviteteve u promovua libri “ Skulptori që ngjall heronjtë“,i artistit të mirënjohur Idriz Balanit vlerat e të cilit reflektojnë në skulptura të ndryshme nëpër Kosovë, ndër të cilat edhe në shtatoren monumentale të Isa Boletinit në Isniq,të Jusuf Gervallës e të Ali Hadrit në Pejë, etj. Për librin folën Sanije Thaçi, Esat Loshaj dhe Aver Husaj. Me këtë rast, komuna e Deçanit cmimin për kontribut ne letërsi “Epopeja e Dukagjinit” e ndau për herë të parë tek I mirënjohuri, shkrimtari, diplomati dhe përkthyesi Besnik Mustafaji. Ndërsa, Cmimi poetik “Jusuf Gërvalla” nga juria e përbërë mga Ajne Iberhysaj,Musa Berisha dhe Ajete Pavataj ia ndanë poetit kuksjan, Rexhep Shahut.
Aktivitetet u organizuan nga Ajen Ibërhysaj dhe ekipi organizativ komunal.Për programin artistik u përkujdes Grupi I Valleve “Deçani”, nën përkujdesjen e Vjollca Tetaj dhe Genc Genci Tetaj.Poezi nga poeti atdhetar Jusuf Gërvalla interpretoi Fatjon Dobraj. Ndërsa, në përmbyllje të aktivitetit poetët pjesëmarrës u nderuan me mirënjohje nga Komuna e Deçanit.

# Ansambli Folklorik Autokton “Rugova”, shënoi 75 - vjetorin e themelimit, aktiviteteve dhe punës




Pamje nga vendi i ngjarjes

Perla e trashëgimisë kulturore shpirtërore AFA “Rugova” përmes të bukurës në artin e lëvizjes, valles, këngës, artit të lirë, natyrshmërisë, pastërtisë dhe estetikës shpalosi pasuri të çmuara kombëtare

Krenaria dhe fisnikëria e Alpeve tona AFA “Rugova”, kjo gurrë e pashuar tradite dhe ky burim frymëzimi për breza, në mbrëmjen festive me rastin 75 – Vjetorit të jetës, punës, dritës dhe rritës, të mbajtur më 23.12.2022, në sallën Univers, Pejë, para afro 1000 të ftuarish shpalosi ritualet e jetës dhe trashëgimisë shpirtërore të lashtë sa vetë populli që e përfaqëson, përmes të bukurës në artin e lëvizjes, këngës, valles, artit të lirë, natyrshëm, pastër, estetik; shpalosi këtë pasuri të çmuar kombëtare, me ç’rast kjo

minierë emocionesh prezantoi eposin artistik plot histori, duke paraqitur njëherësh simbolikat dhe shprehjet më origjinale të intuitës krijuese dhe të imagjinatës së popullit tonë.

Pjesa e parë
Promovimi i dy librave




Pamje nga vendi i ngjarjes
FOTO GALERI
Manifestimi filloi punën me përurimin e dy librave për AFA "Rugova" si ruajtëse e trashëgimisë, e dokeve dhe e zakoneve të kësaj ane:

Visare të trashëgimisë shpirtërore të Pejës me rrethinë II, AFA "Rugova" – thesar i trashëgimisë kulturore shqiptare, Pejë, 2019 dhe
Lojërat Tradicionale të Rugovës, Sofra pejane si vlerë autentike, Pleqnia në odat e anës së epërme të Dukagjinit.
Librat u botuan nga Qendra Rajonale e Trashëgimisë Kulturore në Pejë, me mbi 1000 faqe, nën përkrahjen e drejtoreshës së kësaj qendre dr. Shpresa Gjonbalaj, me kryeredaktor, përkujdesës dhe përgatitës për shtyp, prof. dr. Zymer (Ujkan) Neziri, ishte kjo një punë e jashtëzakonshme, u shpreh drejtuesi i këtij promovimi dr. Dardan S. Lajqi, e madhe, disavjeçare, me vlerë të pamatshme për trashëgiminë e kësaj ane, sidomos të Krahinës së Rugovës, ku janë ruajtur rrënjët e lashta, të vijimësisë kulturore ilire të gjuhës, të veshjes, të këngëve, të valleve, të riteve e miteve, përdundoi Lajqi.
u mbajt në prani të dhjetëra personaliteteve të shquara nga jeta kulturore, politike, shoqërore dhe shkencore. Për librin e parë me kumtesa u paraqitën:

Prof. dr. Hasan Mujaj, Zyrafete Muriqi - Lajqi, prof., Arbnesha Kelmendi-Draga, prof. dhe prof. dr. Valdet Hysenaj
Kurse për librin e dytë referuan: Nazmi Ibërdemaj, refer ndërkombëtar dhe Indira Hoxha, ekonomiste.
Pjesa e dytë Programi artistik

## 75 – Vjet mburrje dhe krenari



Pamje nga vendi i ngjarjes

## Manifestimi u shënua pikërisht, më 23.12.2012, në sallën e restorantit "Univers" në Pejë, i cili edhe njëherë u bë mbështetje e një aktiviteti i cili ngado që të vështrohej rrezatonte kulturë, art, traditë e histori, në prani të një numri të konsideruar mysafirësh dhe artistësh, në ditëlindjen e 75, me mburrje e krenari prezantoi begatitë shpirtërore të trashëguara dhe të përcjella nga brezi në brez.

## Shumësi pjesëmarrjeje të personaliteve të shquara vendore dhe përfaqësues nga të gjitha trojet etnike

– Vjetorin e AFA e madhështuan shumë personalitete të shquara nga trojet tona etnike, ambasadorja e RK në Itali, znj. Lendita Haxhitasim, konsulli i Përgjithshëm e Republikës së Shqipërisë në Romë z. Franqesk Fusha, deputetët e Parlamentit të Republikës së Kosovës, prof. dr. Nebi Bardhoshi, drejtor i Institutit Albanologjik, Tiranë, Rexhep Kurbogaj, kryetar I KK Pejë, aktivistët Mehemt Bardhi, Gjergj Camaj, Marash Dedvukaj, Ali Daci, Haxhi Lajçi, dhjetëra intelektualë të shquar rugovas të prirë nga prof. dr. Hasan Mujaj, dr. Jeton Kelmendi, dr. Dardan Lajqi, gazetarët Smajl Smakaj dhe Hajdar Mekaj, profesorët Isë Nikçi, Artan Demaj, Zekë Muçkurtaj, veprimtarët Halit Barani, Ali Lajqi, Rrahman Lajqi, Sali Lajqi, po ashtu ishin prezentë edhe pjesëmarrësit e tryezës shkencore e cila u organizua dhe u mbajt nën drejtimin e prof. dr. Zymer (Ujkan) Nezirit: AFA "Rugova" – thesar i trashëgimisë kulturore shqiptare II dhe libri i dytë: "Lojërat Tradicionale të Rugovës" mbajtur në orën 14:00, prof. dr. Hasan Mujaj, prof. dr. Nebi Bardhoshi, prof. dr. Valdet Hysenaj, si dhe krijuesit Agim Deskaj, Riza Dreshaj, Ali Daci, Esat Loshaj, Haxhi Lajçi, Osman Shala etj.
Këtë manifestim gjithëkombëtar e nderuan me pjesëmarrje edhe organizata të dala nga lufta e UÇK-së, veteranë, invalidë, familje të dëshmorëve, pensionistë, përfaqësues të subjekteve shtërore, komunale, politike, kulturore, përfaqësues të institucioneve të komunës së Pejës, udhëheqës e drejtues institucionesh shkencore, arsimore e kulturore…
Shënimi i 75 - Vjetorit të Ansamblit Folklorik Autokton "Rugova", u organizua nën përkujdesjen e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit
Me sponsor gjeneral Radio Televizionin e Kosovës
Përshëndetje domethënëse për pjesëmarrësit

Zëri i drejtuesve Dodonë dhe Valdet Hysenaj shënoi fillimin e një dasme të madhe. Mirë se keni ardhur … qofshi faqebardhë, sepse sonte, me rastin e 75 – vjetorit të jetës dhe punës së AFA “Rugova”, na nderuat me pjesëmarrje.
Përmes paraqitjeve të sontme do të bëjmë prezantimin e vlerave të trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të etnoregjionit të Rugovës, sepse kulturës gjithëkombëtare, kjo krahinë i dha në vazhdimësi vlera të mirëfillta artistike kombëtare që na bashkuan sonte, pra, na bashkoi ky thesar i çmuar popullor, kjo trashëgimi e së kaluarës, e së tashmes dhe e së ardhmes, kjo krenari Jona në rrjedhë motesh, krenari me bardhësi alpesh tona.
Njëherësh të gjitha prezantimet e sontme janë disa nga kryeveprat e trashëgimisë shpirtërore kombëtare me të gjithë elementët e tij dhe sigurisht se do të risjellë në vëmendje pasurinë e çmuar që përçoi dhe po e përçon tek brezat e rinj.
Sonte do të kujtojmë bashkërisht sfidat, rrugëtimin dhe vështirësitë që përballoi sot e 75 vjet ansambi, për lumin e sukseseve, për paraqitjet unike me folklorin burimor rugovas, për namin, vendin që i bëri vetes në qarqet sipërore të kulturës anekënd trojeve etnike dhe më gjerë, për lartësimin dhe nderimin e Krahinës kreshnike të Rugovë, Pejës, Kosovës, Shqipërisë, për kënaqësinë që na ofroi sot, na bashkoi, në shënimin e 75 vjetorit të tij…
Fillimisht një mirëseardhje për pjesëmarrje në dasmën e madhe përmes një përshëndetjeje – kronologji kohërash erdhi nga kryetari i Ansamblit z. Vesel Nikçi.
Ansamble nga Shqipëria dhe Kosova dhe këngëtarë të shquar marrin pjesë në këtë ngjarje të madhe
Ishte i gjatë karvani i emrave dhe këngëtarëve pjesëmarrës të përzgjedhur, dinjitozë, debutes, nga më të dashurit dhe më të dëgjuarit, si dhe i ansambleve të cilat paraqitën elemente nga më të mrekullueshmet, në një atmosferë vërtetë të denjë, çfarë edhe ishte.
Në fillim është paraqitur AFA Rugova, të cilët me programin e tyre u shquan për mozaikun, ruajtjen dhe kultivimin e thesareve muzikore.
Programi u begatua dhe u vazhdua nga:
Grupi Polifonik “Gjergj Arianiti” nga Mallakastra, drejtuar nga korifeu i vërtetë i këngës polifonike Guri Rrokaj, mjeshtër i madh
Ansambli me vlera burimore “Bresana” nga Opoja, drejtuar nga Fejsar Shaqiri prezantoi dromca kulturore autoktone shqiptare të trashëgimisë së Opojës me të gjitha vlerat e mirëfillta që i ka ruajtur gjatë shekujve dhe që i kultivon edhe sot e kësaj dite, që u dallua me karakteristikat e veta si për nga mënyra e rëndë, e qetë dhe burrërore gjatë ekzekutimit, po ashtu edhe për fushën e ndërtimit morfologjik të kërcimit.
Shoqata “Atdhetare-Dukagjini” Shkodër, prirë nga kolonel Ndue Sanaj, e përfaqësuar nga këngëtarët në duet: Gjon Kosteri e Prelë Milani, Gentian Gropaj dhe Bledar Hyseni edhe një herë dëshmoi përfaqësim të denjë në mbroje të vlerave të trashëgimisë, interesave historike dhe kulturore të komunitetit dukagjinas, përmes zërit të bilbilave të saj.
Ansambli “Josip Rela” nga Podujeva, me paraqitje tregoi një panoramë të mirë për avansimin e gjendjes kulturore në përgjithësi, sepse vazhdimisht po ofron vlera të mirëfillta të valles popullore përmes së cilës në mbrëmjen e sontme krijoi një formë unike komunikimi me masën, duke e përmbyllur me mbresëlënie.
Ansambli nga Deçani, udhëhequr nga Genc Tetaj, me repertorin e vet përfshiu vallen e njohur popullore deçanase, vallen dyshe, me ç’rast publikut të gjerë ju mundësua të shijojë vallen më autentike tradicionale të kësaj ane, të luajtur me ngjyra ylberi dhe të ngopur me motive kombëtare.
Ansambli “Dardania” nga Tropoja, nën drejtimin e Deli Metaliut, dëshmoi se është bartës i emancipimit kulturor dhe se kërcimi i tyre është më i vjetër se vet vallja. Artistët tropojanë, me shkëputjet e tyre të vazhdueshme nga toka, dëshmuan se kanë shpirt kreativ, në funksion të pastrimit të shpirtit e trupit të tyre, por edhe në funksion të punës dhe argëtimit, prandaj jo rastësisht i mbushi zemrat e të ftuarve me përshtypje të këndshme dhe gjurmë shumë të ndritshme që do të mbesin në kujtesën e tyre.

Kantautori i baladave hite, Esat Ruka, mjeshtër i madh, i cili në vazhdimësi i dha shumë artit dhe kulturës shqiptare në përgjithësi, interpretoi me timbër të veçantë një këngë kushtuar presidentit historik dr. Ibrahim Rugova, të papërsëdytshmit, burrështetasit me përmasa botërore, këngë kjo të cilës Ruka i dha krah qiellor, duke sjellë para të pranishmëve gëzime dhe emocione.
Për vëllezërit Panxhaj, performimi shkëlqyer folklorik autokton dhe duartrokitjet, ishin treguesi më i mirë dhe i vërtetë i suksesit që gëzonjnë artistët, duke kthyer kështu imazhin artistik e muzikor të trevës së kësaj ane, që e kishte dikur, që të prezantojë vlerat e mirëfillta të etnosit të kësaj treve.
Ansambli Folklorik është një ekip njerëzish krijues që veprojnë si bartës të kulturës dhe traditës, qëllimi i tyre është të ringjallin dhe të forcojnë vlerat kulturore kombëtare dhe traditat e këngës së folklorit rugovas, e një gjë të tillë po i shkon për shtati mjeshtrit të madh të AFA-s Shaban Demaj, i cili shkëlqeu me këngën e tij, për tekstin, muzikën dhe interpretimin autorial, duke lënë mbresa të thella te publiku dhe duke e lartësuar dhe ngritur një monument të ri arti dhe kulture rugovase, pejane dhe shqiptare në përgjithësi.
Me vëmëndje është ndjekur edhe kënga e kënduar nga Agim Hysenaj, si për nga përmbajtja (motive trimërie dhe trima rugovas) po ashtu, edhe për muzikalitetin dhe interpretimin.
Këtë manifestim ikonik folklorik e begatoi paraqitja e doajenit të këngës, Ismet Dema, i cili sërish dëshmoi talentin e tij prej artisti që i kushtoi kohën dhe aftësitë e tij artit të lidhur me traditat kulturore.
Vogëlushi Drin Blakaj me këngën e tij para të pranishmëve mirëprit dhe tregoi qartazi se tashmë është një filiz i ri në skenën e muzikës folklorike për fëmijë.
Filmat e shkurtër dokumentarë, dëshmi për histori
U shfaqën edhe dy filma dokumentarë: Kenagjeqi, në regji të Fatos Lajqit, i prezantuar gjatë tryezës shkencore dhe Kronologji 75 - vjeçare e AFA “Rugova” në përgatitje të Faton Bytyqit i cili njëkohësisht shfrytëzoi arkivin e pasur të përfaqësuesit të ansamblit z. Vesel Nikqit, përgatitjen, përkujdesjen dhe leximin e tekstit Valdet Hysenaj, dokumentarë këta të cilët krijuan një pamje reale të jetës së rëndë të malsorëve në njërën anë si dhe shpalosën rrugëtimin e gjatë dhe të mundimshëm të kryeveprës së artit rugovas AFA “Rugova”, me të gjitha paraqitjet, suksesët dhe kujtimin pë ata që na kanë lënë.
Rugova nderon vlerat
AFA “Rugova”, për kontributin shumëvjeçar dhe shumëdimensional, për përkrahjen dhe çmuarjen e vlerve kulturore kombëtare nderoi me MIRËNJOHJE të veçanta në plaketë:
1. Ministrin e kulturës z. Hajrullah Çeku 2. Komunën e Pejës, z. Gazmend Muhaxheri 3. Elkos Gup, z. Ramiz Kelmendi 4. Kapllan Nikqi, mjeshtër i madh 5. Rifat Berisha, artist i merituar 6. Prof. dr. Zymer (Ujakan) Neziri, studiues folklori 7. Institutit Rajonal të Trashëgimisë – Pejë, dr. Shpresa Gjonbalaj, për përkrahje të ruajtjes së trashëgimisë kulturore të trevës së Rugovës.
MIRËNJOHJE me kopertina
Familjeve kontribuese
Ramë K. Nikqi, Plakaj, Shtupeq i Madh, 2. Rrustem Bajrami, Imeralijaj, Shtupeq i Madh 3. Lake Haxhja, Kuklecaj, Shtupeq i Madh, 4. Ramë Elezi, Ibërdemaj, Shtupeq i Vogël, 5. Isë Elezi, Koshutan, 6. Idriz B. Kelmendi, Gjevukaj, Kuqishtë, 7. Misin Nimani Sejdaj, Kuqishtë, 8. Shpend B. Salihaj, Kuqishtë, 9. Brahë Delija, Smajlaj, Stankaj, 10. Adem Kurtaj, Stankaj, 1 Idriz Lulaj, Stankaj, 12. Haxhi Ceka, Muçkurtaj, Bogë, 13. Shaqir Selmanaj, Haxhaj
Gjeneratat ndër vite
Lirije R. Niqi, 2. Bekë H. Nikqi, 3. Zoje I. Smajlaj, 4. Gjyke Zekaj, 5. Shpresa Lajqi, 6. Violeta Kajtazi, 7. Zenel I. Nikqi, 8. Ramë (Brahim) Nikqi, 9. Shaban Demaj, 10. Florim Nikqi, 1 Fatos Selmani, 12. Rifat K. Nikqi, 13. Dr. Valdet Hysenaj.
Kontribuesve ndër vite
Ujë Rugove, 2. Elsa Mermer, 3. Restorani “Univers”, 4. Idriz Kurbogaj
Post mortum
Shaban S. Muriqi, 2. Bajram Ibishi, 3. Sadik R. Abazaj, 4. Malë Kapllani, 5. Shege Kelmendi

Për bashkëpunëtorë
Dr. Bashkim Lajqi, 2. Vjollca Aliu, QRTKK – Pejë, 3. Xhenet Syka, DRKS Pejë, 4. Valmire Husaj – Latifaj, 5. TV – Fontana, baca Zeqë, 6. Kujtim Shala, 7. Xhelal Teta.
Dhuruan për AFA "Rugova"
Fatmir Zhel Hasani, dy kobure dhe një thikë të vjetër të cilat do të përdoren gjatë vallëzimit, 2. Ajkuna Ibraj – Lajqi, një pkturë me motive të ansamblit, Shoqata "Atdhetare - Dukagjini" Shkodër mirënjohje për për Shaban Demaj, anëtar nderi dhe Minella Kureta, mjeshtër i madh, ndau një mirënjohje për AFA Rugova, në emër të Unionit Artistik të kombit shqiptar, njëherit drejtor i tij.
AFA "Rugova" gjatë kësaj mbrëmjeje u shqua:
Për nivelin e ekzekutimit të pjesëve të caktuara muzikore;
Për dëshminë se kemi forca krijuese të cilave AFA "Rugova" ua mundësoi shpalosjen e artit të tyre;
Për bashkëpunimin e ndërsjellë me grupe dhe individë të caktuar;
Për dëshminë në skenë, si prezantim të frymës vëllezërore gjë që kontribuan për krijimin e imazhit pozitiv për AFA "Rugova", imazh ky i krijuar për 75 vjet radhazi besnikërisht.
Çastet, minutat dhe orët e përjetuara në këtë 75 - vjetor do të mbesin në mbamendjen dhe imazhin e akcilit pjesëmarrës si shënim i veçantë dhe i paharruar.
**Në vend të përfundimit:**
AFA "Rugova" me programin e vet dëshmoi edhe njëherë se kurrë nuk e ka aranzhuar aktivitetin e vet artistik sepse mëtimi i tij ishte dhe është që të ruanin dhe të ruajnë natyrën e tyre të mirëfilltë. Mënyra autentike e të gjitha paraqitjeve, valleve dhe të të kënduarit, si dhe kostumet tradicionale popullore, kontribuojnë në aromën origjinale të ansamblit.
Ky ansambël gjatë historisë së tij të gjatë ka dëshmuar të jetë një pasuri e rrallë, unikate, në ruajtjen e arritjeve tradicionale, kulturore, muzikore dhe artistike të popullit tonë, të vjetra dhe të reja. Dhe tani po vazhdon të jetë një ambasador i shkëlqyer kulturor për etninë tonë në përgjithësi në sjelljen e këtyre thesareve kulturore në vëmendjen e botës më të gjerë.

Peje,31.12.2022 AFA Rugova Shaban Demaj

ANSAMBLI FOLKLORIK AUTOKTON 1947 "RUGOVA" Pejë